



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2018

SESIONI I

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT – ORIENTUESE

Lënda: Letërsi e thelluar

VARIANTI **A**

PJESA I

Kadare

E penguara

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë

Pyetja 6 3 pikë

➤ **Gjendja shpirtërore e Migenës:**

- e tronditur, me ndjenjën e fajit;
- e trishtuar për fatin e Lindës;
- e habitur me fjalët e Lindës;
- e prekur nga situata.

➤ **Figurat letrare:**

Epitete: Tango kaq *e pafundme*.

Epitete, inversion: E fundmja shpresë; të vetmin gëzim që kisha;

Metaforë: pa e çliruar ndërgjegjen nga ndjesia e mëkatit;

Enumeracion/shkallëzim: sqarimin e vështirë, atë që lidhej me ty, brengën që mund t'i shkaktoja, e pabesë

1 pikë Nëse gjen gjendjen shpirtërore që po përjeton Migena.

DHE

2 pikë Nëse identifikon dy figura letrare, bashkë me ilustrimet përkatëse.

OSE

1 pikë Nëse identifikon një figurë letrare, bashkë me ilustrimin përkatës.

0 pikë Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 7 **2 pikë**

➤ **Hapësirat:**

- provinca
- kryeqyteti

2 pikë Nëse identifikon dy hapësirat ku zhvillohen ngjarjet.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një nga hapësirat.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 8 **3 pikë**

➤ **Simbolika**

- Kryeqyteti vjen si mjedis i zhvillimit kulturor dhe si ëndërr e personazhit për t'u lidhur me të, përmes të gjitha formave.
- Provinca nënkupton pengesën, mohimin. Është mjedisi i harrimit, ndrydhjes, veçimit prej të gjithëve. Këtë vjen edhe titulli i romanit.

➤ **Raporti**

- Janë mjedise të kundërt me njëri – tjetrin; i pari i jep kuptim jetës së personazhit, i dyti e çon drejt vetmisë së detyruar.
- Raportet janë të kundërshtisë.

2 pikë Nëse zbulon simbolikën e të dy hapësirave.

OSE

1 pikë Nëse zbulon simbolikën e një prej hapësirave.

DHE

1 pikë Nëse tregon raportin që ekziston midis tyre.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 **2 pikë**➤ **Analiza:**

- Dy vajzat kanë këmbyer vendet. Linda ka dashuruar shkrimtarin, por do ta ndiejë atë përmes përshkrimeve dhe raporteve të Migenës me të.
- Migena vepron në emër të Lindës.

➤ **Shkaqet:**

- Ky dyzim ka ardhur për shkak të pengimit. Linda është rritur në internim dhe është privuar të shkelë në kryeqytet. Për këtë arsye, për të përmbushur sadopak ëndërrën e saj, ajo këmbëhet me Migenën.

2 pikë Nëse analizon në mënyrë të plotë dyzimin midis dy personazheve.

OSE

1 pikë Nëse analizon në mënyrë të pjesshme dyzimin midis dy personazheve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **2 pikë****Përgjigje e plotë**➤ **Të përbashkëtat**

- Linda, sikurse heroi i absurdit, është e huaj në mjedisin ku jeton. Ajo ndihet e papranuar në atë mjedis, prandaj ajo e përjeton si e huaj atë.
- Të dy janë të huaj për mjedisin ku jetojnë.

➤ **Dallimet**

- Linda B shfaqet fisnike, e ndryshme nga mjedisi. Asaj i mungon mjedisi i vet kryeqyteti dhe mbetet e pakuptuar, e mohuar e dënuar e penguar për një krim që s'e ka bërë. Ajo është e destinuar të vdesë për shkak të absurdit të sistemit diktatorial. Ajo ndryshe nga heroi i absurdit e ka kuptuar thelbin e kotësisë së ekzistencës, e ka ndierë qenien e saj pa peshë dhe si heronjtë e ekzistencializmit, në mungesë të lirisë, shkon me vullnet drejt vdekjes si shpëtim nga jeta. Ka këtu një mospërputhje që lidhet me paradoksin e sistemit të diktaturës komuniste.

Përgjigje e pjesshme

Nëse jep vetëm të përbashkëtat ose vetëm dallimet.

2 pikë Nëse krahason në **mënyrë të plotë** Linda B me heroin e absurdit.

OSE

1 pikë Nëse krahason në **mënyrë të pjesshme** Linda B me heroin e absurdit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 11

2 pikë

➤ Të dhënat dhe shpjegimi

- Ti ishe e *fundmja* shpresë - Theksimi i fjalës *e fundmja*, ndryshimi i pozicionit në fjali (inversioni), krijon ndjesinë e diçkaje që po shkon vrulltazi drejt një fundi të paralajmëruar.
- *Më sillje lajme prej botës* - kjo e dhënë krijon ndjesinë e dy botëve: asaj të të gjallëve dhe një tjetër, asaj të harrimit, ku Linda B ndodhet. Mënyra se si ajo shprehet, thekson një përhumbje të personazhit, një përkohshmëri të saj dhe një parandjenjë së diçka do të ndodhë së shpejti.
- *Sepse... ja ku po ta pohoj atë që isha e sigurt se do ta merrja me vete në varr* - theksimi i fjalës *varr*, mbart një nëntekst paralajmërues, nxjerr më në pah gjendjen fataliste të heroinës.
- *Ishte i vetmi shans...që diçka...të dilte....prej meje...matanë*: përdorimi i reticencave, fjala *matanë*, krijojnë idenë e diçkaje paralajmëruese, që pritet të ndodhë dhe kjo nuk ka mundësi të jetë e mirë, përkundrazi. Ka shumë dëshpërim në fjalët e saj, shumë zhgënjim, përhumbje, fatalizëm.
- *...si njeriu që ndien fantazmën*: detaji i fantazmës, krijon analogji me diçka që i takon botës së përtejme. Është një detaj paralajmërues se fundi nuk mund të jetë ndryshe.

1 pikë Nëse identifikon një të dhënë paralajmëruese.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon se pse kjo e dhënë krijon te lexuesi idenë se personazhi do të kryejë aktin e vetëvrasjes.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA II**Kongoli*****Jetë në një kuti shkrepësesh***Pyetja 12 **B** **1 pikë**Pyetja 13 **D** **1 pikë**Pyetja 14 **C** **1 pikë**Pyetja 15 **A** **1 pikë**Pyetja 16 **B** **1 pikë**Pyetja 17 **2 pikë**➤ **Nënteksti i titullit**

- **Titulli është metaforë që zbulon hapësirat e ngushta të jetës.** Përmasat e mjedisit, hapësirës përcaktojnë edhe përmasën e lirisë dhe të zhvillimit të personalitetit. Apartamente të vegjël, njerëz të vegjël, botë meskine, e vogël, e mbyllur, e ndotur, pa ëndrra dhe pa ajër.

➤ **Momenti:**

Edhe nëse më pas fati jua sjell të jetoni mes rehatisë, në hapësira të bollshme, ju siguroj, për këtë mund të flas me kompetencë, bota juaj ka mbetur përjetësisht e vogël, sa një kuti shkrepësesh. Prirja juaj është t'i zvogëloni përmasat, t'ia përshtasni metrit me të cilin jeni rritur. E keqja më e madhe: nocioni i kohës dhe hapësirës e humbasin kuptimin. Ditët rrjedhin monotone...

1 pikë Nëse zbërthen nëntekstin e titullit.**DHE****1 pikë** Nëse identifikon në fragmentin e dhënë një moment që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me titullin e romanit.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 18**3 pikë**➤ **Gjendja psikologjike**

- Gjendja psikologjike e personazhit shfaqet e rënduar, për shkak të krimit të kryer. Ajo merr formë më konkrete në paragrafin e fundit të fragmentit.

Jam peng i pavendosmërisë. qenkam burracak, një frikaman, përderisa duhet të zgjedh njërën nga të dyja dhe të tërhiqem zvarrë nga një dilemë gjoja hamletiane.

➤ **Krahasimi****Përgjigje e plotë**

Dilema e Bledit është të vetëdorëzohet apo jo për krimin e kryer, një krim ordiner si dhe vetë personazhi, që nuk ka asgjë të ngjashme me heroin e idealeve të mëdha të Rilindjes.

Dilema e Hamletit lidhet me misionin e madh **të rrosh apo të mos rrosh* (mjedisi është i molepsur, por heroi është model i qëndresës kundërshtar i këtij mjedisi). Kurse Bledi është produkt i rrethanave, i dorëzuar tek ato dhe jo në luftë me to.

Hamleti është model i vetëflijimit në emër të virtytit, përkundër një heroi të degraduar e po aq i molepsur sa edhe mjedisi.

Në këto kushte analogjia me dilemën hamletiane e shtyn situatën drejt groteskut.

Përgjigje e pjesshme

- Hamleti kërkon të vetëflijohet në emër të virtytit, Bledi jo.
- Nuk ngjasojnë të dy, pavarësisht dilemave që mbartin.

1 pikë

Nëse tregon gjendjen psikologjike që po përjeton personazhi..

DHE**2 pikë**

Nëse krahason në mënyrë të plotë dilemën e tij me atë të Hamletit.

OSE**1 pikë**

Nëse krahason në mënyrë të pjesshme dilemën e tij me atë të Hamletit.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 19 **3 pikë**

- **Figura stilistike metafora.**
- **Interpretimi:**

Përgjigje e plotë

- Për shkak të degradimit të vlerave morale, proces ky i pandalshëm në atë realitet, njeriu mbetet i pafuqishëm. Ai i dorëzohet ligësisë njerëzore e në këto kushte kërkon të gjejë shpëtim në fëmijërinë e tij.
- Guaska e humbur është pikërisht mburoja e së shkuarës, fëmijërisë. Lëvizjet prej kërmilli (krahasim) janë lëvizje të ngadalta, të ndotura si jargët e kërmillit, që burojnë nga degradimi, ndotja, tjetërsimi a deformimi i personazhit për shkak të rrethanave mbytëse të një hapësire të kufizuar.

Përgjigje e pjesshme

- Guska e humbur është në analogji me të shkuarën, fëmijërinë.

OSE

- Lëvizjet prej kërmilli janë në analogji me ndotjen, deformimin e personazhit.

1 pikë Nëse identifikon figurën e stilistikës.

DHE

2 pikë Nëse interpreton **në mënyrë të plotë** imazhin e krijuar.

OSE

1 pikë Nëse interpreton **në mënyrë të pjesshme** imazhin e krijuar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 20**6 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton qëndrimin e vet për pro ose kundër se a ekzistojnë rrethana në të cilat mund të falësh;
- përdor detaje mbështetëse të marra nga përvoja personale apo e të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- respekton elementet e strukturës së esesë:

hyrjen

zhvillimin

përfundimin

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një pershtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**2 pikë**

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.